

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të Raportit	Nr. i lëndës:
<u>Hysni Muhadri</u> 	06.10.2020	15.10.2020	742/20

NENI 105 i LPP-së, BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.09.2020, OE “AC ING SHPK & AAG PROJEKT” SHPK - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 742/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i QMF-së në Veternik”, me numër të prokurimit: 616-19-1234-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, punë, vlera e parashikuar e kontratës: 600,000.00 €.

Data e njoftimit për kontratë.....	04.05.2020.
Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë.....	18.05.2020.
Data e korrigjimit të njoftimit për kontratë.....	21.05.2020.
Data e hapjes së ofertës.....	16.06.2020.
Data e njoftimit mbi vendimin e AK-së.....	16.09.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm.....	08.05.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim “AC ING SHPK & AAG PROJEKT” SHPK – Prishtinë.....	18.09.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....	22.09.2020.

Nuk është e përsëritur ankesa.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

PRETENDIMET ANKIMORE DHE DISPOZITAT E SHKELURA

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, janë:

Neni 1 – Qëllimi;
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës;
Neni 64 – Dëshmitë e kërkesave;
Neni 69 – Aftësitë teknike dhe/ose profesionale;
Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë;
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Te nderuar pasi kemi pranuar " VENDIMI I AK.pdf "për tenderuesin e eliminuar me datë:16.09.2020 ne ora 15:01 në ëeb faqen e E-PROKURIMIT, ku na keni eliminuar me arsyetimin se : Arsyetim Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Për këtë aktivitet eliminoheni pasi qe ne listën tuaj të stafit të cilën e keni prezantuar siç vijon: Ju jeni eliminuar sepse nuk keni dhënë sqarime të argumentuara në kërkesën tone për çmime jo - normalisht të ultë. -Ju po ashtu në vend të sqarimeve jeni marre me këshilla dhe interpretime ligjore që nuk janë në kompetencën tuaj. Për korrektësi ju sqarojmë se kërkesa jonë është bazuar në pikat 3.2 dhe 4.2 për tenderët jo normalisht te ulet: dhe -Keni dorëzuar një deklaram nga furnitor kinse keni te parapaguara sasi te armaturës, por nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi lidhur me këtë. Andaj duke u bazuar ne faktet e mësipërme ju nuk keni përmbushur kërkesat e Autoriteti Kontraktues te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate andaj për këtë aktivitete do të eliminoheni. Ne arsyetimin e juaj shihet qartë se nuk na trajtoni të barabartë nga arsyetimi i juaj sepse ne nuk kemi bërë interpretim të ligjit po ne ju kemi dëshmuar se tenderi jone i plotëson kushtet dhe ju kemi garantuar se ju sjellim sigurimin e ekzekutimit ne vlerë qe ju e kërkon siç kërkohet me ligjet e prokurimit në mënyrë që ju të siguroheni. Gjithashtu ne ju kemi prezantuar edhe kontratë si ju i keni lidhur me OE te cilët kanë çmime përafërsisht të njëjtë me çmimin ton dhe nuk ju keni kërkuar sqarime shtese e as sigurim te ekzekutimit me vlerë më te madhe. Edhe një argument tjetër është se punët e betoni dhe te armaturës janë te lidhura njëra me tjetrën nuk mundet të kryhen punët e betonit pa vendosur armaturën dhe nëse i shikojmë këto te dyja si vlerë ne i kemi :

Totali i punëve të betonit:84,200.60€.

Totali i punëve të armatures:32,896.40€

Kur te mbledhim këto dy totale është vlara:117,097.00€

Kurse GOE i propozuar për kontratë ka këto vlara:

Totali i punëve të betonit:49,260.06€

Totali i punëve të armatures:50,743.80€

Kur te mbledhim këto dy totale është vlara:100,003.86€

Prandaj shihet qartë se tenderi jonë e plotëson kushtet ku keni kërkuar arsyetim për çmimin sepse shumica e tenderëve të dorëzuar nga OE e kanë përafërsisht çmimin totalit te betonit dhe armaturës ngatë ofertës tonë. Ne vendimin e nxjerrur të datës 07.08.2020 për tenderuesin e suksesshëm ku shënon: "Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e

tenderit". Ju na keni shpallur fitues te tenderit sepse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dhëna në njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit ,dhe pas rivlerësimit është po e njëjta dosje e tenderit e cila nuk ka ndryshua.

Ne vendimin e nxjerra të datës 07.08.2020 ne letrat standarde ju nuk keni dërguar për OE GABIMET ARITMETIKE të cilat kanë qenë mbi 2% dhe ne bazë te ligjit LPP-së këta tenderues eliminohet ,por ju gjatë rivlerësimit me datë :01.09.2020 keni ngarkuar ne SEPP KORIGJIM PER LLOGARITJE TE GABUAR, ku GOE i propozuar për kontratë ka gabim aritmetik mbi 2% dhe duhet të eliminohet , sepse arsyetimi i juaj ku shënon "Ju a përkujtojmë se kjo ndryshon çmimin total te ofertës suaj dhe nëse ai ndryshim është me shumë se (+/-2%) tenderi juaj do te refuzohet. Edhe pse ky korrigjim tejkalon korrigjimin e parapare ligjore (+/-2%),tenderi juaj nuk do te refuzohet pasi qe gabimi aritmetik është pasojë e gabimit te Paramasës dhe Paralogarise nga Autoriteti Kontraktues". Ne mendojmë se përgjigjja e AK-së në lidhje me gabimet aritmetike nuk vlejnë sepse nuk e dimë cilit nen të LPP-se i referohet ku thotë se AK-se e ka për detyrë ti krijoj formulat ne excel për OE, sepse është detyrë e OE për krijim e formulat edhe mos me bë gabime ne paramas dhe paralogari. Sikur te ishte paramasa dhe paralogaria e koduar nga AK-së ose te jetë paramasas e standardizuar ne E-prokurim atëherë kish vlejtur përgjigjja e AK-së në lidhje me gabimet aritmetike. GOE i propozuar për kontratë ka gabim aritmetik prej vlerës totale 456,220.95€ , ku pas korrigjimit vlera totale 467,419.21 € ,ku gabimi aritmetik është 2.45% që e tejkalon gabimi e lejuar në vlerë prej 2% sipas LPP-së. Gabimi aritmetik ka ardhur si pasoje e mos mbledhjes ne rekapitullim nga ana e GOE i cili ka shënuar edhe Pozicioni 13 -Punët e Gardhit me vlerë:3,204.56 € edhe Pozicioni 14-Punët e Dyshemeve është bartë po e njëjta vlerë 3,204.56 € ne rekapitullim te punët e Arkitekturës , kurse është dashur të vendoset vlera e Pozicioni 14-Punët e Dyshemeve prej 13,869.54€ dhe ky ndryshim e ka rritur kontratën për 2.45 % -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Prandaj nuk e plotëson këtë kushte. Shembull konkret: KOMUNA E GRAÇANICËS na ka eliminuar prej tenderit : Ndërtimi i ndërtesës së banimit social në Llapnasellë – Faza I për gabim aritmetik mbi 2% edhe pse komuna e ka dorëzuar paramasen me gabim -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Gjatë kontrollimit të dosjes se GOE të propozuar për kontratë në formularin për aplikim të tenderit të periudha e vlefshmërisë se tenderit kemi vërejtur se është shënuar 210 ditë kurse në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është e cekur 90 ditë, prandaj është dashur te eliminohet sepse nuk e ka plotësuar kushtin kryesore administrative, validitetin e ofertës sipas kërkesës se DT dhe njoftimit për kontratë. Shembull konkret: Po i njëjti GOE është eliminuar nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN për formularin për aplikim të tenderit te periudha e vlefshmërisë se tenderit-(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Po i njëjti GOE është eliminuar nga KUVENDI KOMUNAL- GJILAN për formularin për aplikim të tenderit te periudha e vlefshmërisë se tenderit-(Gjeni të bashkangjitur dëshminë).

Siç është kërkesa nga AK-se ne dosjen e tenderit ne piken 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomikë, një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. Konzorcium nuk ka plotësuar kërkesë për formimin e grupit ekonomik siç janë të

specifikuar në kërkesën (a,b,c,d) ,por ka paraqitur vetëm Marrëveshjen e konzorcium ku tregohen ndarja ne % e secilit anëtarë te grupit për kryerjen e punimeve nëse nënshkruhet kontrata. -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Prandaj nuk e plotëson këtë kusht. Siç është kërkesa nga AK-se ne dosjen e tenderit - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme o Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv). Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i arkitekturës min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 1 kontrate te natyrës se ngjashme. Inxhinier i diplomuar i makinerisë (dega Termoenergjetik- Termoteknikë) min. 5 vite përvoje pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme 2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Ne dosjen e GOE te ngarkuar tek lista e stafit nga NNP "Standard "Sh.p.k tek Inxhinier i diplomuar i makinerisë (dega Termoenergjetik- Termoteknikë) min. 5 ka ngarkuar Ing.e makineris Muhamet Bajram Xhyllani ku ne diplome e ka(drejtimin komunikacion) , kurse në DT është kërkuar (dega Termoenergjetik Termoteknikë).Gjithashtu ka bashkangjitur edhe Rasim Mjekiqi ku nuk e plotëson këtë kusht. -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Prandaj nuk e plotëson këtë kusht. Kurse ne listën e stafit te "Arifaj "Shpk tek ing.makineris Edmir Hamit Qerkezi drejtimi e ka (Profili i Mjete transporti) ,kurse ne DT është kërkuar (dega Termoenergjetik- Termoteknikë). -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Prandaj nuk e plotëson këtë kusht. Kurse për teknikun e ndërtimtarisë kanë bashkangjitur një certifikata dhe një diplome te shkollës se mesme edhe këto certifikata nuk janë adekuate sepse tek Maksut Tocilla e ka drejtimin (Teknik Topograf) dhe Fiqiri Tahiri e ka drejtimin -profilin Minatore. -(Gjeni të bashkangjitur dëshminë). Prandaj nuk e plotëson këtë kusht. Siç është kërkesa nga AK-se ne dosjen e tenderit -Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- 4. Operatori ekonomik duhet te ketë Bazë për beton nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim.(4.Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agresioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim). Ne dosjen e tenderit te dorëzuar nga GOE i propozuar për kontratë pas kontrollës se dosjes shihet se nuk e ka ngarkuar Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agresioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohen ne Aneksin 7 te Pajisjet .Prandaj nuk e plotëson këtë kusht. Andaj ju si AK-se nuk e keni respektuar nenin 59 të LPP-së ,sepse na keni eliminuar neve si GOE edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe te njoftimit për kontratë, ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesore për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë sipas nenit 60 paragrafit 1.1 i LPP-së. Ju si AK-së në këtë vlerësim dhe vendim na keni diskriminuar neve si GOE në kundërshtim me nenin 7-të LLP-së dhe njëkohësisht e keni favorizuar GOE të rekomanduar për kontratë, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo -diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente". Ju si AK-së është dashur ta keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën me efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu ju si AK-së nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse jeni te obliguar që të siguronit se fondet

publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Në fund kërkojmë nga OSHP-ja , që të nxjerr:

VENDIM

Aprovohet ankesa e GOE "AC ING" Sh.p.k & "AAG PROJEKT "Sh.p.k, si e bazuar. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së. Te nxjerrët vendimi nga OSHP-ja ku ne të shpallemi fitues si GOE i përgjegjshëm me çmim më të ultë.

FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET – KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1.Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit.

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

3. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore te lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, dhe te vazhdoj me shpërbllim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.

<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.</p> <p>2.Certifikata e numrit fiskal.</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1.Kopja e Certifikatës se biznesit.</p> <p>2.Koja e Certifikatës se numrit fiskal</p>
<p>III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>1.Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,500,000.00 Euro.</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>1.Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.</p>
<p>III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, (ndërtim i larte) ne vlere minimale prej 900,000.00 Euro , në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).</p> <p>2.Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme:</p> <p>Udhëheqës i punishtes - Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë – min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv).</p> <p>Inxhinier i diplomuar i hidroteknikes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>Inxhinier i diplomuar i makinerisë (dega Termoenergjetik Termoteknikë) min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>2. Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>3.Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.</p> <p>4. Operatori ekonomik duhet të ketë Bazë për beton nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim.</p>	<p>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</p> <p>OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.</p> <p>Udhëheqësi i punishtes duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme. o Inxhinier i diplomuar i arkitekturës min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme.</p> <p>Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme.</p> <p>Duhet te ketë udhëhequr se paku 1 kontrate te natyrës se ngjashme.</p> <p>Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme 2 Teknike te ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit.</p> <p>3.OE duhet te plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe</p>

marrëveshjen për shfrytëzim.
4.Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni pasi ka analizuar ofertat, duke marr parasysh të gjitha kërkesat e FDT-së, për këtë lende, rekomandon ZP që fitues të shpallet OE NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK – Prishtinë, që ka ofertuar me çmim në vlerë: 467,419.21€.

Ky rekomandim i komisionit vlerësues është aprovuar dhe është bërë Njoftimi mbi vendimin e AK-së me 16.09.2020.

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK – Prishtinë, ka ofertuar në vlerë totale të ofertës:456,756.88€.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS SË OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK – Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-së, përmes Letrës standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët, i ka kërkuar sqarime OE ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT SHPK".

Punët e Armimit nga pos. 4.1 deri tek pos.4.12, ku çmimi i armimit (furnizimi, prerja, lakimi, pastrimi dhe montimi), i ofertuar për kg është 0.40€.

Si total çmimi i juaj prej 32,896.40€, është çmim jo-normalisht i ulët në krahasim me tenderët tjerë.

Ju duhet të sqaroni në mënyrë të detajuar çmimin tuaj dhe formimin e tij për këtë pozicione, duke përfshirë dëshmitë e çmimeve nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar, dëshmitë e prodhimit apo blerjes me çmime nga prodhuesit për llojin e mallit dhe mënyrën e realizimit të projektit me çmimin e dhënë ose favorit tuaj lidhur me furnizimet të këtyre mallrave.

Operatori ekonomik i përgjigjet AK-së, shih dëshmitë më poshtë:



Emri i AK: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Adresa e AK: **TREPQES NR.2**

Qyteti: **PRISHTINË**

Titulli: **"Ndërtimi i QMF-se ne Veternik"**

Numri i prokurimit: **616-20-1234-5-1-1**

Numri i brendshëm: **616 20 025 511**

Nga: **"AC ing" Sh.p.k & "AAG PROJEKT" Sh.p.k -Prishtinë**

Lënda: **Sqarime për pozicionet: Punët e Armimit**

Data: **02.09.2020**

Në lidhje me kërkesën për sqarim për pozicion e armaturës nga ana juaj ne do ju ofrojmë dokumentet dëshmi për këtë pozicion.

Sqarime për pozicionet:

Punet e Armimit nga pos.4.1 deri tek pos 4.12 ku çmimi i armaturës (furnizimi ,prerja,lakimi,pastrimi dhe montimi) i ofertuar per kg eshte 0.40€.

Si total çmimi i juaj prej 32.896,40 eshte çmim jo-normalisht i ulet ne krahasim me tenderuesit tjere

Arsytimi:

Ne si konsorcium kemi ofruar çmimin 0.40 € për 1kg për arsye se jemi bazuar në çmimin e furnizimit nga furnizuesi për këtë projekt. Pasi ne kemi bërë parapagim për armature gjatë kohës së pandemisë kur çmimi ishte i favorshem në treg, pasi ka pasur ulje në bërzhë .

Kurse sa i përket punës së dorës ne si konsorcium e kemi llogaritur te puna e betoni,prandaj ne kemi ofruar çmimin per kg-0.40 €.

"Tenderët Jo-normalisht të Ulët"

"AK do të kërkoj nga OE për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen te gjitha kushtet e mëposhtme:

çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
janë dorëzuar të paktes 3 (tre) tenderë."

Oferta jonë nuk mundë te quhet Jo-normalisht të Ulët sepse nuk ka asnjëren nga kto kriteter te cekura ne lartë sipas LPP.



"Siguria e Ekzekutimit per Tenderët Jo-normalisht të Ulet"

"AK gëzon te drejtën që përqindjen e kërkuar të sigurimit të ekzekutimit ta rris për mbulim të dëmeve dhe shpenzimeve që AK mund të parasheh që do të ndodhin nëse shkëputet kontrata."

Ne si konsorcium jemi të gatshëm të ju sjellim sigurimin e ekzekutimit me vlerë më të lartë se 10% në mënyrë që tju sigurojmë se do ta përfundojmë kontratën ashtu siç e lejon edhe ligji i cekur me lartë .

Ne kemi shikuar edhe ne e-prokurim kontrata e publikuar nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES dhe kemi vërejtur se çmimi i armatues është afër me çmimin tonë dhe ne mendojmë se nuk e kemi çmimin jo-normalisht i ulët në krahasim me tenderuesit tjerë .(Gjeni të bashkangjitura si dëshmi kontrata).



"AAG PROJEKT" Sh.p.k





Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-19-1234-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP).



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar¹

Nr. i prokurimit	616-20-1234-5-1-1
Nr. i brendshëm	616 20 025 511

Grup i Operatorëve Ekonomik AC ing SH.P.K.; AAG PROJEKT SH.P.K.,

Titulli: „Ndërtimi i QMF-se ne Veternik’

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht e papërgjegjshme:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet
- ☐ Nuk i keni plotësuar Specifikimin Teknik të dhënë në Aneksin I
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Gabimi(et) aritmetikor i evidentuar(a) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ☐ X Oferta e juaj, në përputhje me nenin 61.4 është konsideruar si oferte abnormalisht e ulët.
- ☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Për këtë aktivitet eliminoheni pasi që në listën tuaj të Stafit të cilën e keni prezantuar siç vijon :

Ju jeni eliminuar sepse nuk keni dhënë sqarime të argumentuara në kërkesën tone për çmime jo –normalisht të ulta.

- Ju po ashtui ne vend te sqarimeve jeni marre me këshilla dhe interpretime ligjore qe nuk janë ne kompetencën tuaj. Per korrektësi ju sqarojmë se keresa jone eshte bazuar ne pikat 3.2 dhe 4.2 per tenderët jo normalisht te ulet ; dhe
- Keni dorëzuar nje deklaram nga nje furnitor kinse keni te parapaguara sasi te armaturës , por nuk keni dorëzuar asnjë dëshmi lidhur me kete.

Andaj duke u bazuar ne faktet e mësipërme ju nuk keni përmbushur kërkesat e Autoriteti Kontraktues te kërkuara ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate andaj për këtë aktivitet do te eliminoheni.

- ☐ Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me Respekt!

Në nenin 4.6 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, thuhet : ***Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose:***

4.6.1 Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose

4.6.2 Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, ne përputhje me nenin 61 te LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, **"Njoftim për refuzim te tenderit abnormalisht te ulet"**, brenda dy dite nga data e vendimit.

Gjithashtu në nenin 61 paragraf 3, thuhet: ***Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar një shpjegim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë.***

Andaj duke pasur parasysh nenin 4.6 të Rregullat për Tender jo –Normalisht të Ulët si dhe 61 të LPP-së, mendoj se është e drejtë dhe përgjegjësi e AK-së, se pas sqarimeve të marruara në lidhje me tenderët jo normalisht të ulët të vendos që një tender ta trajtoj me tenderët tjerë.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Autoriteti kontraktues përmes letrës standarde për njoftim të llogaritjes së gabuar e njofton OE të rekomanduar për dhënie të kontratës NNP"STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK , Ku i thotë se si rezultat i korigjimeve Vlera totale e ofertës, nuk është 456,220.95€, por 467,419.21, dhe e pranon se gabimet aritmetike e tejkalon korigjimin e paraparë ligjorë +2%, mirëpo e arsyeton se nuk do të refuzohet tenderi juaj se AK-së, kanë gabuar në paramasë dhe parallogari, shih më poshtë:



Letër Standarde për njoftim të

Llogaritjes së gabuar

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2 - PRISHTINË

„Grup i Operatorëve Ekonomik nnp Standard shpk; Arifaj.shpk

Nr. i prokurimit	616-20-1234-5-1-1
Nr i brendshëm	616 20 025 511

Titulli: „Ndertimi i QMF-se ne Veternik“

Te nderuar!

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 siç citohet në vazhdim “ LPP ”.

Gjatë ekzaminimit të tenderit të juaj kemi gjetur gabim(e) aritmetik(e). Gabimi ose gabimet kanë të bëjnë në pozicione, të cilat ndryshojnë në totalin e ofertës tuaj:

Gjate llogaritjes se ofertës suaj kemi vrejtur këto gabime aritmetike lidhur me këto pozicione :

Pasi që gabimi është evidentuar totali i ofertës suaj ka pësuar ndryshime ,për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur ne kemi korigjuar gabimin duke bërë amendamentet vijuese të tenderit të juaj:

Si rezultat i korigjimit Vlera Totale e ofertës suaj nuk është 456,220.95€ por është 467,419.21€.

Ju a përkujtojmë se kjo ndryshon çmimin total të ofertës suaj dhe nëse ai ndryshim është me shumë se (+/- 2%) tenderi juaj do të refuzohet.

Edhe pse ky korigjim tejkalon korigjimin e parapare ligjor (+/-2%) , tenderi juaj nuk do të refuzohet pasi që gabimi aritmetik është pasojë e gabimit të Paramasës dhe Parallogarise nga Autoriteti Kontraktues.

Nëse nuk pajtoheni me këtë (këto) amendament(e), ju lutem të na kontaktoni menjëherë me shkrim _ në adresën : prokurimi.prishtine@rks-gov.net ose në platformën elektronike me hapat si ne vijim :

SHENIM: Ju lutem sqarimet t'i dorëzoni përmes platformës. Mos ngarkoni dokumentet tek butoni "Sqarimet e dosjes se tenderit " sepse tani jemi në fazën e vlerësimit dhe ai buton tashmë është mbyllur. Butoni "Sqarimet e dosjes se tenderit" përdoret gjatë fazës


Eksperti shqyrtues konstaton se në pikën 3 të nenit 59 të LPP-së, thuhet: “Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve, sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës”.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “AC ING SHPK & AAG PROJEKT” SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i QMF-së në Veternik”, me numër të prokurimit: 616-19-1234-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP).

ii. Në rast se shuma e korigjuar është me shume se $\pm 2\%$, AK do të eliminoj OE dhe do të informoj me shkrim OE në fjale duke përdorur formën standarde B42.

Andaj bazuar në nenin 59 paragraf 3 të LPP-së, si dhe në pikën (ii) të nenin 41.8 të RRUOPP-së, AK-së është dashur të eliminoj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ankues NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, në dosjen e tenderit i kanë ofruar zotërinjtë Rasim Mjekiçi, Muhamet Xhyllani dhe Edmir Qerkezi, të cilët janë Inxhinier të Makinërisë, mirëpo në Diplomën e asnjërit nuk figuron (dega Termoenergjetik Termoteknikë), shihe dëshmitë.



United Nations Interim
Administration Mission in Kosovo



Universiteti i Prishtinës
University of Prishtina

FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING

DIPLOMA

IN UNIVERSITY EDUCATION

MUHAMET BAJRAM XHYLANI

BORN IN BAICE-GLLOGOVIC ON 17 FEBRUARY 1980

REGISTERED IN THE ACADEMIC YEAR 1998/99

COMPLETED ALL THE REQUIRED EXAMINATIONS

AT THE FACULTY OF MECHANICAL ENGINEERING

SECTION OF TRANSPORT AND TRAFFIC

ON 21 DECEMBER 2006 AND OBTAINED

THE UNIVERSITY TITLE

GRADUATE MECHANICAL ENGINEER

Average grade of studies 6.74

Diploma conclusion grade

FAKULTETI I INXHINERISË MEKANIKE

DIPLOMË

E KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR

MUHAMET BAJRAM XHYLANI

LINDUR NE BAICE-GLLOGOVIC ME 17 SHKURT 1980

REGISTRUAR NE VITIN AKADEMIK 1998/99

ME 28. 12. 2006 I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARA

PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E MAKINERISË

DREJTIMI I KOMUNIKACIONIT

DHE ME KËTË MERR KUALIFIKIMIN

INXHINIER I DIPLOMUAR I MAKINERISË

Nota mesatare gjatë studimeve 6.74

Nota e provimit të diplomës 9.00

PRISHTINË, ME 28 SHKURT 2007, NR. 256

Dekani

Prof. Dr. Ismail Gajani

Rektori

Prof. asc. Enver Hasani

SOCIJALISTIČKA FEDERATIVNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA
SOCIJALISTIČKA REPUBLIKA HRVATSKA



SVEUČILIŠTE U ZAGREBU
FAKULTET STROJARSTVA I BRODOGRADNJE U ZAGREBU

DIPLOMA

O STEČENOJ VISOKOJ STRUČNOJ SPREMI



RASIM MJEKIĆ

rođen 28. lipnja 1952. u Shipitullë, Socijalistička Republika Srbija, Kosovo, završio
je dana 30. svibnja 1980. na ovom fakultetu studij
STROJARSTVA
u trajanju od deset semestara.

Fakultet strojarstva i brodogradnje u Zagrebu utvrđuje da je
RASIM MJEKIĆ

udovoljio svim propisima za stjecanje visoke stručne spreme, postigao visoku stručnu
spremu i stekao stručni naziv

DIPLOMIRANI INŽENJER STROJARSTVA

kao i sva prava koja mu pripadaju po propisima.

U Zagrebu, 30. svibnja 1980.

Broj: 4239/IV a 7909

Dekan
Dr FEDERICO DUŠMAN

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se për teknikët e ndërtimtarisë ka bashkangjitur një Diplomë të shkollës së mesme dhe një Certifikatë, ku Maksut Tacolli ka titullin teknik Topogaf dhe Fiqiri Tahiri ka titullin minator.

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosjen e tenderit janë kërkuar "Teknike të ndërtimtarisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit".

OE i rekomanduar për dhënie të kontratës në dosjen e tenderit e ka ofruar Certifikatën dhe Diplomën të cilat i ka i ka cekur OE ankues, për më tepër shih dëshmitë më poshtë.

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TURIZMIT
Komisioni i Dhënies së Licensave Profesionale

LICENSE
17.0378

MBIEMRI	TOCILLA
EMRI	MAKSUT
ATESIA	XHEMAL
DATELINDJA	22.09.1960, Kukës
VENDBANIMI	KUKËS
DIPLOMUAR, ME	1979
TITULLI	Teknik Topograf
Rregjistruar në Rregjistrin	
të mësuar që nga data:	17.06.2002

NË ZBATIM

Kat. 1	Gërmime dhe me punime eventuale murature e beton arme – Prishje dhe punime në toke të gërmuar.
Kat. 2	Prodhim materiale inerte – gurë.
Kat. 14	a Pastrimi i sipërfaqes urbane.
	b Kryerja e punimeve në shërbesat funerale.
Kat. 15	a Rivëlme topografike.
	b Punime topogjeodezike në objekte inxhinierike.

KRYETARI I KOMISIONIT
Anton DIERA

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim".

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, nuk ka ofruar dëshmi për kërkesën "Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale". Mirëpo pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar Marrëveshje në mes të NNP "STANDARD" SHPK & TITAN BETON" L.L.C, si dhe kopjen e Licencës të kërkuar, për më tepër shih dëshmitë më poshtë:

MARRËVESHJE PËR FURNIZIM ME BETON DHE SHFRYTËZIM TË MAKINERISË

Lenda: Marrëveshje për Furnizim me Beton dhe Shfrytëzim të Makinerisë

Partnerët:

1. "Titan Beton L.L.C" me NIF: 810541715 themeluar në Prishtinë, përfaqësuar nga Gëzim Bytyqi Drejtor
2. Standard shpk me NIF: 810448507 themeluar në Prishtinë, përfaqësuar nga Vehbi Zariqi Drejtor

Lenda: Marrëveshje për Furnizim me Beton dhe Shfrytëzim të Makinerisë

Të cilët më tutje do të quhen si bashkëpunëtorët, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Palët njëzëshm u pajtuan për Furnizim me Beton nga kompania Titan Beton si dhe dhënia në shfrytëzim të Makinerisë për Standard shpk

Marrëveshja është në bazë vjetore për vitin kalendarak 2020-2022

Furnizuesi është punëtor i Fabrikës së Betonit dhe i Makinerisë.

Neni 2

Palët u pajtuan që çmimet të caktohen me aneks të veçantë për secilin punë veç e veç.

Neni 4

Palët u pajtuan që blerësi duhet të parashtrijë kërkesën për furnizim në shfrytëzim së paku 7 ditë para kohës që i nevojitet.

Neni 5

Palët u pajtuan që pagesat të bëhen sipas marrëveshjeve të veçanta pas kërkesës së porositësit.


Neni 6

Marrëveshja tym në fuqi me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes nga të dyja palët.

Palët e marrëveshjes:

1. "Titan Beton L.L.C"
Z. Gëzim Bytyqi
2. Standard shpk
Z. Vehbi Zariqi

Prishtinë, 29.05.2020



Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-19-1234-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP).

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Operatori ekonomik ankues "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar Licencë të vlefshme nga Agjensioni për miniera dhe minerale dhe nuk i ka ngarkuar pajisjet për furnizim me beton siç kërkohet në Aneksin 7 të pajisjet

Eksperti shqyrtues sqaron se tek njoftimi për kontratë dhe dosje të tenderit konkretisht te dëshmitë dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT", dhe tek dëshmitë dokumentare është kërkuar: "OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj listën e pasjeve duke plotësuar Aneksin 7 te Dosjes se Tenderit dhe duhet te bashkëngjis Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim".

Operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës NNP "STANDARD SHPK & ARIFAJ" SHPK, pas kërkesës së AK-së, për sqarime shtesë, përveç Marrëveshje në mes të NNP "STANDARD" SHPK & TITAN BETON" L.L.C, kopjes së Licencës, i ka ofruar edhe Librezat e pajisjeve, për më tepër shih dëshmitë më poshtë:

A. Niveli i sigurimit B. Niveli i sigurimit C. Niveli i sigurimit		D. Niveli i sigurimit E. Niveli i sigurimit F. Niveli i sigurimit		G. Niveli i sigurimit H. Niveli i sigurimit I. Niveli i sigurimit	
J. Niveli i sigurimit K. Niveli i sigurimit L. Niveli i sigurimit		M. Niveli i sigurimit N. Niveli i sigurimit O. Niveli i sigurimit		P. Niveli i sigurimit Q. Niveli i sigurimit R. Niveli i sigurimit	
S. Niveli i sigurimit T. Niveli i sigurimit U. Niveli i sigurimit		V. Niveli i sigurimit W. Niveli i sigurimit X. Niveli i sigurimit		Y. Niveli i sigurimit Z. Niveli i sigurimit AA. Niveli i sigurimit	

A. Niveli i sigurimit B. Niveli i sigurimit C. Niveli i sigurimit		D. Niveli i sigurimit E. Niveli i sigurimit F. Niveli i sigurimit		G. Niveli i sigurimit H. Niveli i sigurimit I. Niveli i sigurimit	
J. Niveli i sigurimit K. Niveli i sigurimit L. Niveli i sigurimit		M. Niveli i sigurimit N. Niveli i sigurimit O. Niveli i sigurimit		P. Niveli i sigurimit Q. Niveli i sigurimit R. Niveli i sigurimit	
S. Niveli i sigurimit T. Niveli i sigurimit U. Niveli i sigurimit		V. Niveli i sigurimit W. Niveli i sigurimit X. Niveli i sigurimit		Y. Niveli i sigurimit Z. Niveli i sigurimit AA. Niveli i sigurimit	

A. Niveli i sigurimit B. Niveli i sigurimit C. Niveli i sigurimit		D. Niveli i sigurimit E. Niveli i sigurimit F. Niveli i sigurimit		G. Niveli i sigurimit H. Niveli i sigurimit I. Niveli i sigurimit	
J. Niveli i sigurimit K. Niveli i sigurimit L. Niveli i sigurimit		M. Niveli i sigurimit N. Niveli i sigurimit O. Niveli i sigurimit		P. Niveli i sigurimit Q. Niveli i sigurimit R. Niveli i sigurimit	
S. Niveli i sigurimit T. Niveli i sigurimit U. Niveli i sigurimit		V. Niveli i sigurimit W. Niveli i sigurimit X. Niveli i sigurimit		Y. Niveli i sigurimit Z. Niveli i sigurimit AA. Niveli i sigurimit	

A. Niveli i sigurimit B. Niveli i sigurimit C. Niveli i sigurimit		D. Niveli i sigurimit E. Niveli i sigurimit F. Niveli i sigurimit		G. Niveli i sigurimit H. Niveli i sigurimit I. Niveli i sigurimit	
J. Niveli i sigurimit K. Niveli i sigurimit L. Niveli i sigurimit		M. Niveli i sigurimit N. Niveli i sigurimit O. Niveli i sigurimit		P. Niveli i sigurimit Q. Niveli i sigurimit R. Niveli i sigurimit	
S. Niveli i sigurimit T. Niveli i sigurimit U. Niveli i sigurimit		V. Niveli i sigurimit W. Niveli i sigurimit X. Niveli i sigurimit		Y. Niveli i sigurimit Z. Niveli i sigurimit AA. Niveli i sigurimit	

[illegible]

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues
- OE ankues

- Kuvendi Komunal Prishtinë (**KKP**).
- OSHP.
- OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "AC ING SHPK & AAG PROJEKT" SHPK - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i QMF-së në Veternik", me numër të prokurimit: 616-19-1234-511, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë (KKP).